



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"**  
**REKTORATI**

---

Nr. \_\_\_\_\_ prot

Elbasan, më \_\_\_\_ .07.2019

Lënda: Dërgim njoftimi për shpallje konkursi për vend të lirë pune.

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK**  
**DREJTORISË SË PUBLIKIMIT TË NJOFTIMEVE**  
**TIRANË**

Bashkëngjitur gjeni njoftimin për konkurs për personel administrativ me kohë të plotë që zhvillon Rektorati i Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

**ADMINISTRATORI**

**Eljan Hoxha**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**  
**REKTORATI**

---

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” shpall konkurs për pozicionin e punës, personel administrativ, *Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Prokurimeve* në Rektorat.

**Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Prokurimeve:** organizon, bashkërendon dhe mbikqyr veprimtarinë e drejtorisë dhe përgjigjet tek Administratori për realizimin me efektivitet të detyrave dhe objektivave, si dhe funksionimin e sektorëve të kësaj drejtorie. Koordinon dhe menaxhon punën brenda drejtorisë, si dhe bashkëpunon me strukturat e tjera përbërëse të UE-së. Raporton tek titullari, harton raporte, kryen analiza periodike dhe propozon zgjidhje në rastet kur është e nevojshme, në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

**Kritere të përgjithshme:**

- të ketë mbaruar studimet universitare të ciklit të dytë (Master i Shkencave) në inxhinieri/ shkencë të natyrës (ekonomi). Diplomat e ciklit të parë duhet të jenë të së njëjtës fushë studimi me atë të ciklit të dytë. Diplomat të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë të njohura dhe njësuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.
- të ketë përvojë pune.
- të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.
- ndaj tij të mos ketë masë disiplinore në fuqi.
- të jetë i aftë për punë

**Kritere të veçanta:**

- të ketë jo më pak se një vit pune në pozicion drejtues ose të ngjashëm me të.
- Të ketë jo më pak se 3 (tre) vite pune në profesion.
- të ketë kryer kurse apo kualifikime në fushën e shërbimeve/prokurimeve brenda e jashtë vendit.
- të ketë njohuri të mira të gjuhëve të huaja.
- njohës dhe përdorues programeve kompjuterike.
- të ketë aftësi të mira menaxhuese, komunikuese e të punës në grup.

Kandidatët duhet të dorëzojnë në Drejtorisë së Burimeve Njerëzore Protokoll Arkiv të Rektoratit të Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” dokumentacionin e kërkuar në rrugë postare nga data **15.07.2019** deri datë **25.07.2019** këto dokumente:



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**UNIVERSITETI I ELBASANIT “ALEKSANDËR XHUVANI”**  
**REKTORATI**

---

- Letër motivimi për pozicionin e punës *Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve dhe Prokurimeve*
- Jetëshkrimin e tij/saj;
- Fotokopje e diplomës e njehsuar me origjinalin. Nëse aplikanti disponon një diplomë të një universiteti të huaj, atëherë ai duhet ta ketë të njehsuar atë pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin;
- Fotokopje e listës së notave e njehsuar me origjinalin. Nëse ka një diplomë dhe listë notash të ndryshme me vlerësimin e njohur në Shtetin Shqiptar, aplikanti duhet ta ketë të konvertuar atë sipas sistemit shqiptar;
- Fotokopje e njesuar e librezës së punës;
- Çertifikata, kualifikime, rekomandime për aftësi të ndryshme, të njësuar me origjinalin;
- Referenca pune nga punëdhënës apo bashkëpunëtorë;
- Dëshmi e njohjes së gjuhës së huaj e njehsuar me origjinalin;
- Raport mjeko – ligjor, që vërteton aftësinë për punë;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore;
- Fotokopje e letërnjoftimit.

Dokumentacioni i kërkuar të dorëzohet në **rrugë postare** nga data **15.07.2019** deri më **25.07.2019** në adresën:

**Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”,**  
**Rruga “Ismail Zyra”,**  
**Aplikim për pozicionin e punës: Drejtor Prokurime Shërbime**  
**Elbasan**

Komisioni ad-hoc do të vlerësojë dosjet e kandidatëve paraprakisht dhe më pas ata do të nënshtohen intervistës me gojë. Konkursi paraprak do të zhvillohet në Rektoratin e UE-së, sipas afateve. Kandidatët konkurues do të njoftohen elektronikisht për rezultatet paraprake të konkurrimit dhe shpalljen /njoftimi i fituesit.

Për çdo sqarim mund të kontaktoni në adresën elektronike [burimetnjerezore@uniel.edu.al](mailto:burimetnjerezore@uniel.edu.al).